



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **18/2025**

Data: **10 mars, 2015. Ora: 11:00**

Vendi: **Selia e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana

Në takim ishin të Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Këshillat e KQZ

2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

2.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KOZ-së:

Kryetari Radoniqi, tha se është një pikë e rendit të ditës, dhe pastaj kërkoi nga anëtarët miratimin e rendit të ditës. Me 9 vota për, u miratua rendi i ditës.

2. Këshillat e KOZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve:

Arianit Elshani: KOZ, e ka shqyrtuar këtë rekomandim nga QNR për verifikimin e disa kutive të votimit, meqë nuk kemi një tolerancë, pra kemi zero tolerancë prandaj, janë identifikua 15 vendvotime ku ka mospërputhje. Këto vendvotime, ne rekomandojmë që të ketë rinumërim të plotë të këtyre 15 vendvotime që, nuk janë vetëm të një komune por, janë me shtrirje në gjithë vendin.

Sa i përket rekomandimit të dytë, ai ka të bëjë me raportin e kandidatëve të LDK-së në vendvotime në komunën e Vushtrrisë. Pra, lidhur me rezultatet e kandidatëve. Raporti i mospërputhjeve, apo të i ndryshimeve mes rezultateve në QKN dhe rezultateve të dala në QNR, ka ardhur si rekomandim që 35 vendvotime të shkojnë në rinumërim të plotë.

Më qartë, 35 vendvotime do të numërohen, pra votat e të gjithë kandidatëve të të gjitha subjekteve politike. Duam ti heqim të gjitha dyshimet, dhe ti shohim rezultatet reale.

Rekomandojmë që, të miratohet ky propozim i KOZ-it.

Diskutuan: Sami Kurteshi, në fakt shtroi pyetje lidhur me fillimin e numërimeve, qoftë për 177 kutitë e diskutuara në mbledhjen e kaluar, dhe kjo në Vushtrri...? Ai, u interesua edhe lidhur me një ankesë, në fakt për afatin e saj të dërguar në PZAP, e cila e ka shpallë ankesën e lëvizjes Vetëvendosje ! si të pa afatshme...

Lidhur me këto pyetje, z. Buzhala tha se Sekretariati sapo të merr vendim KQZ lidhur me Vushtrinë, është e gatshme të filloj rinumërimi. Kurse për votat jashtë vendit, ato 177 kutitë, vlerësimi i tyre bëhet në atë se ne kemi pranuar vendimin e PZAP-së. Sapo të konsumohet afati në Supreme, qysh nesër ne mund të fillojmë...

Ky rast, lidhet me konsumimin e afatit të palëve në këtë gjykatë..

Sa u përket QKN-ve, ka përfunduar afat i numërimit. Po ashtu, ka njoftim në faqen e KQZ-së ku thuhet se procesi i numërimit të votave me postë jashtë Kosovës, ka përfunduar me 4 mars, në ora 16:00. PZAP-ja, ju ka referuar këtij afati...

Diskutimet më tej, u fokusuan në rrjedhën e procesit të këtyre rekomandimeve, shpjegimit të tyre, pra rreth zhvillimit të përfundimit të procesit. Diskutuan: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e rekomandimeve të QNR-së ?

Me 9 vota për, miratohen këto dy rekomandime.

3. Të ndryshme !

Në vazhdim, u diskutua lidhur me mënyrat e votimit të rekomandimeve, të vendimeve, procedurat e votimit brenda agjendave të KQZ-së. Diskutuan: Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi.

Në vazhdim, Alban Krasniqi, u interesua rreth përfundimit të afatit të numërimit të votave nga jashtë vendit.

Gordana Llaban, tha se Sekretariati i shërben KQZ-së, por jo përpara mediave. Pra, aspektet teknike, ato të informimit të anëtarëve të KQZ etj., duhet të jenë taksative, të shpejta dhe në rend të parë...